VENDIM
Nr. 10, datë 20.1.2020

MBI KËRKESËN PËR MOS LICENCIMIN E SHOQËRISË "MP-HEC" SHPK NGA ERE DHE KËRKESËN PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 187, DATË 25.11.2019, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "MP-HEC" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "NIÇË"

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 67 dhe nenit 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 16, pika 1, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 14/1 prot., datë 16.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë"

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, vendosi të licencojë me kusht shoqërinë "MP-HEC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë", me kapacitet të instaluar 2270 Kw, për një afat 24 vjet e 2 muaj.

- Deri në plotësimin e kushteve të parashikuara në këtë vendim, shoqëria nuk mund të operojë e për rrjedhojë të sjellë efekte për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

- Në vijim të këtij licencimi në ERE ka mbërritur shkresa e z. Petrit Kutolli, protokolluar në ERE me nr. 782/1, datë 12.12.2019, me anë të së cilës ky i fundit ka paraqitur kërkesë për mos licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k. nga ERE, duke kërkuar pengimin e këtij licencimi deri sa proceset gjyqësore civile apo penale të ngritura kryesisht apo në të cilat janë palë ankuesi dhe administratorja e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., të zgjidhen gjyqësisht.

- Kërkesa sipërcituar ka ardhur pas përfundimit të afateve për pritjen e komenteve e objeksioneve siç është parashikuar në nenin 10, pika 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si dhe pas marrjes së vendimit për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k. me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, të Bordit të ERE-s.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 782/3, datë 19.12.2019, z. Petrit Kutrolli, në cilësinë e palës së interesuar, ka ndryshuar objektin e kërkesës së tij, sipërcituar, dhe ka kërkuar rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë".

- Në bazë të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Konstatohet se kërkesa për rishikim të vendimit të ERE-s është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në zbatim të nenit 16, pika 2, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi do të shqyrtojë

provën e re dhe do të nxjerrë vendimin e tij brenda 30 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës për rishikim.

- Ankuesi pretendon, ndër të tjera, se znj. A.Xh., administratore e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., ka paraqitur dokumente të rreme dhe të falsifikuara për aplikimin për licencim në ERE.

- Në mbështetje të pretendimeve për paraqitjen e dokumenteve të rreme, ato lidhen drejtpërdrejtë me procesin e licencimit të subjektit, janë vërtetimet e gjykatave për statusin në proces të procedimeve penale në të cilat palë e paditur rezulton administratorja e shoqërisë së licencuar.

- Sa më sipër, përbën një rrethanë të re, të ndryshme nga ato për të cilat ERE është shprehur me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë".

- Në zbatim të nenit 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

- Për shkak të kompleksitetit të çështjes në shqyrtim, nevojës për verifikime që lidhen me vërtetimin se shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata), janë rrethana që kërkojnë zgjatjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së ankuesit, me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar të mbështetur në prova, të verifikuara dhe të konfirmuara nga organet kompetente.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të shtyjë shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, "Për licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë'", me 30 (tridhjetë) ditë, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi

2. Të sigurohen vërtetimet e nevojshme nga organet shtetërore, si dhe gjyqësore me qëllim shqyrtimin në afat të kërkesës për rishikim të vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti